

DEMOKRACIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

TË RINJTË SI PARTNERË NË MIRËQEVERISJE

Udhëzues mbi instrumentat ligjorë për përfshirje dhe transparencë në politikbërje

Dikensa Gjokutaj
Korrik 2022



Sanksionimi i të drejtës për informacion dhe konsultim publik ka qenë në fokus që prej 2014-ës, ritheksuar në ligjin kuadër për rininë në mbështetje të të rinjve.



Komisioni Evropian vlerëson kuadrin ligjor dhe atë institucional për sigurimin e këtyre të drejtave dhe rekomandon zbatim më përmbajtësor dhe përfshirës.



Ndërgjegjësimi i të rinjve mbi përdorimin e këtyre të drejtave është kyç për përmirësimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe fuqizimin si partnerë në mirëqeverisje.

Tabela e përmbajtjes

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2	E DREJTA E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI SIPAS ‘VËSHTRIMIT’ TË KOMISIONIT EVROPIAN	7
3	INSTRUMENTAT LIGJORË PËR INFORMIM, KONSULTIM DHE BASHKËQEVERISJE	8
3.1	E drejta për informim	8
3.2	E drejta për Konsultim Publik	9
	Platforma e konsultimit publik (regjistri elektronik).....	9
	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI-IPSI).....	10
	Platforma e konsultimit on line e projektligjeve të Kuvendit.....	11
	Konsultimi i Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm.....	11
	Vlerësimi i ndikimit të aktit (VN-RIA).....	12
	Platforma e Partneritetit për Integrimin European.....	12
3.3	E drejta për Bashkëqeverisje	13
4	TË RINJTË SI PARTNERË NË MIRËQEVERISJE	15
5	REKOMANDIME	19
6	DOKUMENTE TË KONSULTUARA	20
7	ANEKSE	22

1

PËRMbledhje Ekzekutive

Qytetaria aktive në proceset e politikbërjes është komponent kyç i demokracisë pjesëmarrëse. *'Pjesëmarrja në jetën demokratike të çdo komuniteti është më tepër se sa thjesht votimi apo kandidimi në zgjedhje...Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive do të thotë të gëzosh të drejtën, mjetet, hapësirën dhe mundësinë dhe, kur është e nevojshme, mbështetjen për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në vendime dhe për t'u angazhuar në veprime dhe aktivitete për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë.'*¹ Promovimi i aksesit në informacion, konsultimit publik dhe rritjes së ndjeshmërisë qytetare të rinjtë lidhur me përdorimin e mjeteve ligjore dhe institucionale për hartim dhe monitorim të politikave publike, janë elementë të rëndësishëm për nxitjen e mirëqeverisjes, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Sipas OECD-së² *'angazhimi i qytetarëve në bërjen e politikave është një investim i shëndoshë dhe një element thelbësor i qeverisjes së mirë. Kjo i lejon qeveritë të përdorin burime më të gjera informacioni, perspektiva dhe zgjidhje të mundshme dhe përmirëson besimin tek qeveritë duke përmirësuar demokracinë dhe forcimin e kapaciteteve qytetare.'*³ Informimi është një hap i parë në edukimin e rinjve në demokraci, duke i bërë qytetarisht më të përgjegjshëm për t'u angazhuar në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre. E drejta për informim dhe për t'u konsultuar janë parakushte për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve publike.

Në mbështetje të kësaj fryme, ligji nr. 75/2019 *"Për rininë"* ngarkon ministrinë përgjegjëse për rininë të sigurojë zhvillimin e konsultimeve me rinjtë lidhur me politikën dhe programet rinore në vend, si dhe programet ndërkombëtare të shkëmbimit rinor. Po ashtu ngarkohen dhe institucionet e tjera qëndrore që të marrin mendimin e rinjve për politika sektoriale me target të rinjtë,⁴ duke

mbështetur kështu fuqizimin e rinjve dhe **garantuar pjesëmarrjen e tyre në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse.**⁵

Në këtë punim synohet të evidentohen disa nga mjetet kryesore ligjore dhe institucionale, të cilat janë në mbështetje të frymës së këtij ligji duke siguruar qasje për rinjtë në informacion publik, konsultim dhe bashkëqeverisje, si partnerë në mirëqeverisje. Për një përdorim sa më përmbytësor të këtyre instrumenteve është me vlerë ndërgjegjësimi, informimi dhe rritja e kapaciteteve të rinjve në përdorimin e tyre. Përmbledhje e instrumenteve të cilat do të referohen në këtë punim është si më poshtë.

E drejta për informacion është rrënjësore për angazhimin qytetar, e sanksionuar që në Kushtetutë. Në nenin 23 të saj garantohet e drejta për t'u informuar dhe për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Po ashtu në këtë nen paraqiten elementë të qeverisjes së hapur duke i dhënë të drejtë kujtdo që të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.⁶ Kjo e drejtë dhe instrumentat për sigurimin e saj, artikullohet më tej në ligjin kuadër për të drejtën e informimit duke i mundësuar çdo individ akses në informacion publik nga autoritetet publike nëpërmjet Koordinatorit të së drejtës për informim. Informacioni mund të sigurohet edhe nga platformat zyrtare dhe **Programi i Transparencës** në uebfaqet zyrtare të autoriteteve publike, apo nga platforma të tjera qeveritare si **Portali Open Data.gov**.

E drejta për t'u përfshirë në konsultim publik është mundësi për të angazhuar rinjtë në proceset e politikbërjes duke qenë aktorë në proceset e konsultimit publik të akteve ligjore/nënligjore dhe politikave rinore. Portali i Konsultimit Publik, është instrumenti elektronik bazë në zbatim të ligjit për konsultimin publik. Ky portal është planifikuar të jetë i integruar në **Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar** të qeverisë shqiptare si sistemi bazë për hartimin dhe monitorimin e dokumentave strategjikë dhe politikave.

1 Këshilli i Evropës, Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life, 2015.

2 Organization for Economic Co-Operation and Development

3 OECD, Citizens as Partners: Information, Consultation and Public Participation in Policy-Making - Country Case Studies, 2001.

4 Neni 5/g dhe 6/a, Ligji nr. 75/2019 "Për rininë"

5 Neni 4/b, Ligji nr. 75/2019 "Për rininë"

6 Kushtetuta e Shqipërisë, neni 23.

Së dyti, Kuvendi siguron mundësinë e konsultimit të projektligjeve që shqyrtohen në komisionet parlamentare nëpërmjet **platformës elektronike** të dedikuar këtij procesi.

Së treti, kuadri ligjor i hartimit të **Buxhetit Afatmesëm** legjitimon mundësinë e konsultimit dhe pjesëmarrjes gjatë procesit të hartimit, në nivel qendror dhe lokal. Kjo mundësi mund të shfrytëzohet nga të rinjtë për të siguruar dhe Buxhetim të përgjegjshëm.

Së katërti, procesi i integritimit evropian është i një rëndësie madhore për Shqipërinë dhe si i tillë angazhimi dhe zëri i të rinjve po ashtu është me vlerë. **Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian** është një

dritare për të kontribuar në këtë strukturë negociuese të integritimit në përputhje me të drejtën e informimit si dhe njoftimit publik.

Angazhimi i qytetarëve në proceset politikbërëse është qëllim edhe i programit të **'Bashkëqeverisjes me qytetarët'** përmes platformës "Me ty për Shqipërinë që duam". Kjo platformë është një bazë të dhënash shtetërore, e organizuar në bazë seksionesh dhe ka si qëllim të adresojë në kohë reale çështje të aktualitetit politik e qeverisës, për të diskutuar reforma e masa të rëndësishme duke mundësuar ndikimin e personave fizikë dhe juridikë mbi politikën qeverisëse në çdo sektor apo mbi ecurinë e punës së çdo ministrie dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore.

2

E DREJTA E INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI SIPAS ‘VËSHTRIMIT’ TË KOMISIONIT EVROPIAN

Në Raportin për Shqipërinë 2021 të Komisionit Evropian është vlerësuar ecuria në zbatimin e reformës së administratës publike si *‘e përgatitur në mënyrë të moderuar’*. Konstatohet fakti se janë shtuar institucionet të cilat kanë implementuar programin e transparencës si dhe është dyfishuar numri i autoriteteve publike të cilat kanë implementuar regjistrimin e kërkesave sipas ligjit për të drejtën e informimit i cili konsiderohet si një ligj *‘sipas standardeve evropiane’*.

Për sa i përket të drejtës për konsultimin publik, vlerësohet se ueb-portali elektronik është funksional dhe korniza rregullative është përmirësuar përmes miratimit të udhëzimeve për përgatitjen e planeve vjetore si dhe raporteve në janar. Po ashtu është pozitiv fakti që është rritur numri i akteve ligjore që kalojnë konsultim publik dhe përdorimi i regjistrimit elektronik.

Transparenca buxhetore konsiderohet *‘e kënaqshme’* duke marrë në konsideratë publikimin e dokumenteve kyçe buxhetore, si buxheti vjetor, buxheti i qytetarëve dhe një listë e investimeve publike përfshirë dhe partneritetin publik-privat (PPP), në kuadër të programit buxhetor afatmesëm. Po ashtu është vlerësuar ngritja e kapaciteteve të ministrive të linjës për të implementuar Vlerësimin e Ndikimit të akteve rregullatore (i cili do të trajtohet në vijim), miratimi i udhëzuesve për konsultimin publik,

ngritja e sistemit elektronik për planifikimin e integruar të politikave apo dhe ngritja e platformës së Parlamentit për konsultimin e draft ligjeve.

Krahas njohjes së ecurisë në zbatim të instrumenteve ligjore/institucionalë që sigurojnë të drejtën për informim dhe konsultim publik, Raporti i KE-së identifikon dhe problematika në përdorimin efektiv të tyre. Lidhur me sigurimin e së drejtës për informim rekomandohet përforsimi i rolit të koordinatorëve për të drejtën e informimit në autoritetet publike. Për sa i përket Konsultimit të politikave dhe legjislativës, vlerësohet se ky proces duhet të jetë më përmbytësor për të rritur përfshirjen dhe transparencën veçanërisht për çështje që adresojnë BE-në. Funksioni i kontrollit të cilësisë në konsultimin publik duhet të forcohet për t’u fokusuar më shumë në përmbytje sesa në proces. Komunikimi me qytetarët për reformat në vazhdim duhet të përmirësohet. Kuadri rregullator për planifikimin e integruar të politikave duhet të përmirësohet si dhe të shoqërohet me rritjen e kapaciteteve për planifikimin dhe monitorimin e politikave. Edhe për sa i përket transparencës në organin ligjvënës, Kuvendin, pavarësisht vlerësimit për ngritjen e platformës së konsultimit të draft-ligjeve, sipas raportit *‘konsultimi publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit është formal dhe i limituar në impaktin e tij’*^{7 8}.

3.1 E DREJTA PËR INFORMIM

Ligji nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’

3

INSTRUMENTAT LIGJORË PËR INFORMIM, KONSULTIM DHE BASHKËQEVERISJE

Ligji nr. 119/2014 'Për të drejtën e informimit' rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, pa u detyruar të shpjegohen motivet e kërkesës për informacion. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Sipas procedurës së rregulluar në këtë ligj, kërkesa për informim⁹ bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike në adresën e publikuar nga autoriteti publik të **Koordinatorit për të drejtën e informimit (Aneksi 1)**¹⁰, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Gjithashtu kërkesa për informim bëhet dhe nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*. Kërkesat e depozituara nga ky portal gjithashtu regjistrohen në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji duke iu caktuar dhe një numër rendor. Ky numër, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepen kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

Ligji parashikon në nenin 14 trajtimin e kërkesave për informacion nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, edhe nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-albania.al*. Në këtë kuadër është duke u punuar për sigurimin e këtij instrumenti shtesë, i cili do të përdoret me qëllim pritjen

e aplikimeve për kërkesat dhe kthimin e përgjigjeve për qytetarin në rastet kur informacioni/dokumentacioni kërkohet elektronikisht nëpërmjet portalit e-Albania.

Përgjigja e kërkesës për informim si rregull duhet të kthehet jo më vonë se **10 ditë pune** nga dita e dorëzimit të saj, përveç disa rasteve të posaçme të parashikuara. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve konsiderohet refuzim dhe çdo person ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë **Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** brenda 30 ditëve pune nga dita kur ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit apo ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi në të kundërt ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës administrative kompetente.

Si rregull, shërbimi për dhënien e informacionit është pa pagesë. Rastet përjashtimore, kur dhënia e informacionit bëhet kundrejt një tarife, duhet të jenë përcaktuar më parë dhe bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Çdo individ që paraqet kërkesë ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

Gjithashtu, në kuadër të këtij ligji, autoritetet publike detyrohen për të zbatuar **programin institucional të transparencës**, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Ky informacion duhet të jetë në formate lehtësisht të kuptueshme, të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen internet. Autoriteti publik duhet të krijojë, mbajë dhe bëjë publik një **regjistër të posaçëm**, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Regjistri duhet të përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet po ashtu dhe në faqen e internetit të autoritetit publik pa zbuluar identitetin e kërkuarve të

9 Formati i kërkesës gjendet në faqet zyrtare të autoriteteve publike. Shembull: Model-Kërkesë-për-Informacion.pdf (avokaturashitetit.gov.al)

10 Në aneksin 1 gjendet listë të adresave elektronike të Koordinatorëve të disa prej institucioneve kryesore bazuar në publikimet e autoriteteve publike.

informacionit.¹¹

Bazuar në kuadrin ligjor për “Për të drejtën e informimit”, si dhe “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ka zhvilluar portalin **opendata.gov.al**. Ky portal është i bërë nga tri module kryesore dhe synon të shërbejë si një vend konsultimi mes qytetarëve dhe institucioneve vendimmarrëse në Shqipëri, si edhe si një pikë unike e publikimit të të dhënave të hapura qeveritare. Portali Open Data ofron të dhëna të hapura dhe të standardizuara mbi legjislativën dhe projektat ligjorë, buxhetin dhe shpenzimet e qeverisë, statistikën, regjistrimin e biznesit, performancat e sistemit të edukimit dhe atij shëndetësor e të tjera. *‘Qëllimi i portalit Open Data është qeverisje më efiçente dhe efektive, rritje ekonomike dhe inovacion, transparencë dhe përgjegjshmëri, promovimi i ripërdorimit të informacionit publik duke respektuar të drejtën e pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.’*¹²

3.2 E DREJTA PËR KONSULTIM PUBLIK

Ligji nr. 146/2014 ‘Për njoftimin dhe konsultimin publik’

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”

Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike kanë qenë në fokus me miratimin e Ligjit nr.146/2014 ‘Për njoftimin dhe konsultimin publik’ në vitin 2014. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik duke përcaktuar rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Organet publike, sipas këtij ligji, detyrohen të marrin masat që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik. *‘Çdo masë e ndërmarrë në këtë kontekst është një hap më tej në krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën publike duke mbrojtur dhe lobuar për interesat e tyre legjitime. Pjesëmarrja e gjerë e publikut në këto procese kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e*

*demokracisë.*¹³

Instrumentat kryesorë në mbështetje të zbatimit të këtij ligji janë së pari publikimi në regjistrin elektronik të projektaktit në të cilin bëhet njoftimi për konsultim dhe publikohen të dhënat të lidhura me konsultimin e projektakteve, përfshirë Vlerësimin e Ndikimit i cili do të referohet në vijim. Së dyti, publikimi i informacionit në Programin e Transparencës.

Organet publike caktojnë Koordinatorë të Njoftimit dhe Konsultimit Publik përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik. Nëpërmjet Koordinatorit institucionet duhet të japin informacion në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë gjithashtu dhe konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara.¹⁴

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë” e thekson detyrimin e institucioneve publike për konsultimin me të rinjtë të politikave dhe programeve rinore në vend si dhe programet ndërkombëtare të shkëmbimit rinor¹⁵ duke mbështetur kështu fuqizimin e të rinjve dhe **garantuar pjesëmarrjen e tyre në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse.**¹⁶ Objekti i ligjit përfshin mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve. Tërësia e akteve të tjera ligjore dhe instrumentat që ato sigurojnë për akses dhe përfshirje të qytetarëve në informacion, konsultim dhe bashkëqeverisje janë në mbështetje të arritjes së objektivit të ligjit kuadër për sektorin e rinisë.

Platforma e konsultimit publik (regjistri elektronik)

Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike aksesohet në platformën konsultimi.gov.al. Ky regjistër është i integruar në portalin qeveritar e-Albania duke përdorur të njëjtën bazë të dhënash të përdoruesve, pa nevojën e regjistrimit të veçantë. Në këtë platformë publikohet *Plani vjetor për projektat që do t’i*

11 Ligji nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’.

12 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021 ‘Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021– 2023’, faqe 260.

13 Departamenti i Administratës Publike, Raporti Vjetor i Monitorimit 2020, Tiranë, prill 2021, fq. 14

14 Ligji nr. 146/2014 ‘Për njoftimin dhe konsultimin publik’

15 Neni 5/g dhe 6/a, Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”

16 Neni 4/b, Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”

nënshtrohen konsultimit publik.

Si rregull, palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik komentet dhe rekomandimet e tyre brenda 20 ditëve pune. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit. Çdo i interesuar mund të kërkojë informacion tek autoriteti publik për procesin e konsultimit sipas detyrimeve të aktit ligjor dhe afateve të parashikuara në platformë.¹⁷

Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI-IPSI)

Në kuadër të përmirësimit të sistemit të politikbërjes me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)" është krijuar baza e të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS). Sistemi është dizenuar të përdoret nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme që marrin pjesë në hartimin e kuadrit të politikave publike afatgjata për Republikën e Shqipërisë. Ky është sistemi kryesor për planifikimin, analizën, përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike, si dhe për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuar. Raportet e monitorimit, të cilat duhet të jenë publike, do të jenë bazë informuese si dhe referencë për të kërkuar informacion mbi ecurinë e masave të dokumentave strategjikë.

Ky sistem është planifikuar të ndërveprojë me sisteme/platforma të tjera qeveritare: së pari me **Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENKP)** duke marrë të dhëna mbi komentet e marra nga konsultimi publik i dokumenteve strategjike dhe politikave; Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (SIMF); Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe Sistemin Informatik të Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (SIMNH), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat; Sistemin e Arkivit të Akteve të Qendrës së Botimeve Zyrtare (Sistemi i QBZ) në administrim funksional të ministrisë përgjegjëse për botimet zyrtare; Bazën e të Dhënave Statistikore, në administrim të Institutit të Statistikave dhe Platformën për të Dhëna të Hapura.¹⁸ Krijimi i IPSIS pritet të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të planifikimit të politikave dhe monitorimit

duke vendosur standarde të unifikuara dhe më të qarta në procesin e politikbërjes.¹⁹

Këshilli i Ministrave ka miratuar në 29 tetor 2021 ngritjen e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndhmës (SASPAC) me mision sigurimin e hartimit, zbatimin dhe harmonizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, bashkërendimin e ndihmës së huaj, bashkërendimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar.²⁰ Ky institucion do të administrojë edhe bazën e të dhënave shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit të ndihmës së huaj (SIMNH) dhe sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI). Më ngritjen e këtij institucioni të ri, është e pritshme që të jetë në fokus dhe rekomandimi i KE-së mbi përditësimin e kuadrit rregullator mbi planifikimin e integruar të politikave dhe rritjen e kapaciteteve për planifikimin e politikave dhe monitorimin duke vënë në zbatim sistemin e integruar të hartimit të politikave.²¹

Platforma e konsultimit on line e projektligjeve të Kuvendit

Përveç projektakteve, të cilat duhet të konsultohen sipas planit vjetor në platformën e konsultimit publik, Kuvendi po ashtu ofron mundësinë e konsultimit online të projektligjeve që komisionet parlamentare publikojnë, me qëllim "respektimin e parimit të transparencës dhe për një Kuvend të hapur e sa më pranë qytetarit, në faqen zyrtare të platformës "Konsultimi i Projektligjeve".²²

Çdo individ, organizatë e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit mund të regjistrohet dhe të ketë mundësi të adresojë komente apo sugjerime konkrete që do t'i shërbejnë komisioneve parlamentare në procesin e legjislativ të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve për përmirësimin e tyre. Sipas KE-së, të paktën deri në vitin 2020, "konsultimi publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit kanë qenë formalë dhe të kufizuara në impakt."²³ Në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) theksohet rritja e transparencës në procesin legjislativ dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Mendimet dhe

17 Plani Vjetor për projektaktet për t'ju nënshtruar konsultimit publik për vitin 2021 https://konsultimipublik.gov.al/documents/REN-JK_335_I.Plani%20Vjetor%20KP%202021.pdf

18 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)".

19 Departamenti i Administratës Publike, Raporti Vjetor i Monitorimit 2020, Tiranë, prill 2021, fq. 14

20 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 29.10.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndhmës"

21 European Commission, Albania 2021 Report, Brussels

22 Kuvendi, Platforma e Konsultimit të Projektligjeve, <https://konsultimi.parlament.al/>

23 European Commission, Albania 2021 Report, Brussels, fq. 11.

sugjerimet e tyre të paraqitura në seanca dëgjimore, ose me shkrim janë shqyrtuar dhe ky proces është pasqyruar në raportin që ka shoqëruar projektligjin në seancën plenare. Risi po ashtu konsiderohet forcimi i mëtejshëm i transparencës në veprimtarinë e Kuvendit duke mundësuar transmetimin livestream të mbledhjeve të komisioneve parlamentare në faqen e internetit të Kuvendit www.parlament.al. *'Ky transmetim livestream e forcon transparencën e procesit ligjvënës të Kuvendit si dhe aksesin e mediave dhe të qytetarëve në këtë proces'*.²⁴

Konsultimi i Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm

Një instrument llogarikërkues i rëndësishëm është edhe procesi i konsultimit të Planifikimit Afatmesëm të Buxhetit bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 *'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë'*, i ndryshuar si dhe në Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, nr. 19 datë 9.7.2020.

Sipas Udhëzimit plotësues, në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje, në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, gjatë përgatitjes së PBA, duhet të organizohet takim konsultativ me përfaqësues të shoqërisë civile. Në takim duhet të prezantohet dokumenti paraprak i PBA-së, duke i njohur të interesuarit me objektivat politikë, treguesit e performancës përkatëse dhe produktet e planifikuara për çdo program buxhetor.

Sugjerimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile, me arsyet e argumentura për marrjen ose jo në konsideratë, duhet të jenë pjesë e një aneksi të veçantë, duhet të dorëzohen në Ministrinë përgjegjëse për financat së bashku me kërkesat buxhetore të PBA. Ministrinë e linjës që kanë fushën e tyre të përgjegjësisë, sektorët e shëndetësisë, punësimit, strehimit, mirëqenies sociale dhe arsimit, janë të detyruar të marrin masa që në takimin konsultativ me shoqërinë civile të njoftojnë ndër të tjera dhe advokuesit Rom dhe Egjiptian për pjesëmarrje.

Pas përfundimit të seancave dëgjimore me Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Qendrore, Ministria përgjegjëse për financat gjithashtu kërkohet të organizojë një takim konsultativ me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Në këtë takim diskutohet propozimi për shpërndarjen e burimeve buxhetore në përputhje me politikën e programeve buxhetore për periudhën 2022-2024, me fokus qëndrimin e shoqërisë civile mbi këtë propozim. Minutat e këtij takimi së bashku me aneksin e dorëzuar nga Ministrinë e linjës sipas këtij udhëzimi duhet të reflektohen në një aneks të veçantë të dokumentit të Programit Buxhetor

Afatmesëm 2022-2024.²⁵

Në Raportin e KE-së 2021 vlerësohet transparenca buxhetore me publikimin e dokumenteve kyçe buxhetore, si buxheti vjetor, lista e investimeve publike, duke përfshirë partneritetin publik-privat (PPP), në kuadër të programit buxhetor afatmesëm. Gjithsesi *'pjesëmarrja e publikut në procesin buxhetor duhet të forcohet më tej'*.²⁶

Vlerësimi i ndikimit të aktit (VN-RIA)²⁷

Një prej prioriteteve të reformës në Administratën Publike është realizimi i vlerësimit paraprak të ndikimit të projektakteve. Ky proces vlerësimi ex-ante i alternativave është legjitimuar në vitin 2018 nëpërmjet VKM nr. 197, datë 11.4.2018 *'Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"*, të ndryshuar, dhe konsoliduar nëpërmjet metodologjisë së vlerësimit të ndikimit, mars 2018. Nëpërmjet saj synohet rritja e cilësisë dhe efektivitetit të hartimit të politikave/legjislationit, për të dhënë rezultate më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Transparenca është parim themelor i rregullimit/politikbërjes së mirë dhe Vlerësimi i Ndikimit ndihmon në arritjen e këtij objekti. Për këtë arsye, është e domosdoshme që procesi i VN të shpjegojë qartë se është ndjekur procesi i rregullit të konsultimit publik, kur janë marrë vendimet dhe se rezultatet e këtij procesi janë publikuar. VN duhet të publikohet nga Ministria përkatëse së bashku me projektaktin dhe relacionin shpjegues në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, si dhe në faqe të tjera të nevojshme (faqet zyrtare të Ministrive).²⁸

Duhet të publikohen raportet e VN që vijojnë:

- Gjatë fazës së konsultimit publik. Raporti i VN duhet të publikohet gjatë fazës së konsultimit së bashku me projektaktin/politikën, për të cilën bëhet konsultimi. Raporti i VN, gjithashtu mund të publikohet edhe pas kësaj faze në mënyrë që të përditësohet si rezultat i konsultimeve (kjo në diskrecionin e Ministrisë përkatëse).

²⁵ Udhëzimi plotësues i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, nr. 19 datë 9.7.2020.

²⁶ European Commission, Albania 2021 Report, Brussels, fq. 13.

²⁷ Vendim nr. 197, datë 11.4.2018 *'Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"*, të ndryshuar

²⁸ Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit, mars 2018

²⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021 *'Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023'*.

- Pas fazës finale. Kur projektakti është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe është dorëzuar në Parlament.

Të interesuarit për t'u angazhuar në konsultim publik, mund të shqyrtojnë dokumentin e vlerësimit të ndikimit për kuptueshmëri më të gjerë të projektaktit. Vlerësimi i ndikimit shqyrton çështjet e politikës/legjislacionit të propozuar si dhe zgjidhjet e problematikave të ndryshme, të cilat trajtojnë pyetjet në vijim:

- Cila është politika apo problemi që po shqyrtohet?
- Cilat grupe ndikohen nga politika apo problemi?
- Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?
- Çfarë opsionesh po shqyrtohen?
- Cilat janë përfitimet, kostot dhe risqet e pritshme të secilit opsion?
- Cili është opsioni i preferuar dhe pse – cilat rrethana e mbështesin atë?
- Si do të zbatohet opsioni i preferuar?
- Si do të monitorohen dhe do të vlerësohen efektet e ndryshimeve të politikave pas zbatimit?²⁹

Sipas raportit të monitorimit 2020 të Strategjisë së Reformës në Administratën Publike *'procesi i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) ka sjellë rezultate pozitive në rritjen e cilësisë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit në Shqipëri duke drejtuar ndërhyrjen aty ku është e nevojshme, nëpërmjet analizave të vlerësimit të projektligjeve para miratimit të tyre. Procesi tashmë është pjesë e proceseve të politikbërjes si dhe është i shtrirë dhe në proceset legjislativë në Parlament.*³⁰

Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian

Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian është pjesë e strukturave negociuese të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ku synohet të realizohet informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja. Platforma është ngritur nëpërmjet Urdhrit nr.113 të Kryeministrit datë 30.12.2019 *"Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian"*, në mbështetje të pikës 39 të kreut IX, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018, *"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian"*. Kjo platformë mbështetet dhe funksionon në përputhje me të drejtën e informimit si dhe njoftimit publik për:

- projektvendimin negociues të Republikës së Shqipërisë për kapitullin përkatës të *acquis*;
- programimin dhe monitorimin e ndihmës së Bashkimit Evropian;
- hartimin e Planit kombëtar Për integrimin Evropian ose të planeve të tjera në kuadër të procesit të integritit evropian;
- çështje të tjera të cilat duhet të këshillohen me strukturat joshitetërore të përfaqësimit publik, në kuadër të procesit të integritit.

Platforma e Partneritetit ka si qëllim:

- të rrisë ndërgjegjësimin publik në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- të shpjegojë ndikimin e procesit të anëtarësimit për vendin dhe shoqërinë;
- të informojë mbi negociatat dhe progresin e bërë për çdo fazë;
- të mbështesë përfaqësim gjithëpërfshirës të të gjithë partnerëve;
- të mundësojë akses të shoqërisë civile, pushtetit vendor, komunitetit të biznesit, shoqatave të punëmarrësve, botës akademike dhe grupeve të interesit, për këshillim e monitorim në fazat e programimit dhe zbatimit të asistencës së Bashkimit Evropian.³¹

Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian përbëhet nga dy nivele përfaqësimi, Bordi Drejtues dhe Tryezat e diskutimit dhe Këshillimit në të cilat duhet të ketë dhe përfaqësi nga shoqëria civile. Bordi drejtues është struktura më e lartë e Platformës, kryesohet nga Kryeministri dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ka në përbërje të tij 15 anëtarë, ndër të cilët: Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme; Kryenegociatori; Drejtuesi i Sekretariatit të Integritit Evropian; Drejtori përgjegjës për bashkëpunimin territorial për zbatimin e projekteve IPA; Drejtori përgjegjës për koordinimin e programeve kombëtare dhe rajonale të IPA; dhe nga dy përfaqësues për këto grupe dhe institucione: shoqatat e organeve të pushtetit vendor; organizatat e shoqërisë civile; komuniteti i biznesit; shoqatat e punëmarrësve; bota akademike.

Për sa i përket tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit, janë 33 të tilla analoge me Kapitujt e *"Acquis"* të Bashkimit Evropian. Tryezat kryesohen nga drejtuesit e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNPIE) dhe koordinohen nga ministritë ose institucionet kryesuese të kapitujve, sipas fushës e kompetencës së tyre. Secila nga Tryezat e

29 Për më shumë shih Metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit, të përgatitur nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore në Kryeministri, me mbështetjen e SIGMA-s, prill 2018.

30 Departamenti i Administratës Publike, Raporti Vjetor i Monitorimit 2020, Tiranë, prill 2021

31 Urdhri nr. 113 i Kryeministrit datë 30.12.2019 *"Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian"*.

Diskutimit dhe Këshillimit ka në përbërje të saj përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, shoqatave të punëmarrësve, botës akademike, medias dhe grupeve të interesit.³² Qëllimi kryesor i secilës tryezë është të diskutojë, të shqyrtojë dhe të ndërmarrë qëndrime dhe rekomandime drejtuar institucioneve. Tryezat gjithashtu duhet të këshillohen në lidhje me programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës së BE-së për Shqipërinë.

Aplikimi për tu bërë pjesë e tryezave kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi dhe CV-je të personit apo të grupimit që përfaqëson ku tregohet se ka ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezën/tryezat specifike. Për ngritjen e tryezave, pranimit apo refuzimi i aplikimeve bëhet nga grupet ndërinstitucionale të punës. Në rastin e anëtarëve të rinj, pranimit ose refuzimi i aplikimit bëhet nga drejtuesit e grupeve ndërinstitucionale të punës dhe refuzimi duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar.³³

3.3 E DREJTA PËR BASHKËQEVERISJE

Platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”

Në datë 4 nëntor 2021, Kuvendi miratoi projektligjin ‘Për Bashkëqeverisjen’. Ky ligj krijon kuadrin ligjor të funksionimit të politikës së qeverisë për Bashkëqeverisjen dhe ndërveprimin me qytetarët me qëllim rritjen e rolit të tyre në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose të programeve të përbashkëta që kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në bashkëqeverisje përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.³⁴

Bashkëqeverisja synohet të realizohet nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve në politikbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore. Po ashtu, synohet të nxitet ndërveprimi ndërmjet administratës shtetërore dhe individëve, organizatave të shoqërisë civile, pavarësisht

formës së tyre të organizimit, si dhe tregtarëve, shoqërive tregtare dhe çdo subjekti të së drejtës që kryen veprimtari tregtare.

Platforma “Me ty për Shqipërinë që duam” është një bazë të dhënash shtetërore, e organizuar në bazë seksionesh dhe ka si qëllim të jetë një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi, për të adresuar në kohë reale çështje të aktualitetit politik e qeverisës.³⁵ Seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” me anë të të cilave mund të kontaktohet institucioni janë:

- **“Ankesa ime”** – Nëpërmjet këtij seksioni paraqiten ankesat për vonesën në marrjen e shërbimit publik apo mospërfitimin e tij, si dhe raportohen sjelljet abuzive të strukturave të administratës shtetërore ose të zyrtarëve të caktuar;
- **“Biznesi im”** – Nëpërmjet këtij seksioni, çdo subjekt privat i pajisur me NIPT ankimon sjelljet abuzive apo joetike, si dhe çdo parregullsi të administratës, të cilat cenojnë klimën e biznesit dhe denoncon vendimmarrje që bien në kundërshtim me aktet rregullatore;
- **“Denonco korrupsionin”** – Nëpërmjet këtij seksioni denoncohen aktet korruptive apo kur konstatohet se në përmbajtje të çështjes ka elemente të një akti korruptiv të ndodhur ose në tentativë;
- **“Nisma ime”** – Nëpërmjet këtij seksioni paraqiten ide për një nismë komunitare apo një projekt konkret me interes publik;
- **“Fjala ime”** – Nëpërmjet këtij seksioni shprehen opinione mbi reformat apo projektet të cilat janë në proces dhe çdo sugjerim, ide e re apo propozim se si mund të përmirësohet qeverisja në tërësi apo rezultatet në një fushë të caktuar duke përfshirë klimën e biznesit po pa u kufizuar në të, politikën e qeverisë për biznesin apo marrëdhënien me administratën, si dhe duke përcjellë sugjerime mbi përmirësimin e klimës së biznesit në vend;
- **“Interpelanca ime”** – Nëpërmjet këtij seksioni, një komunitet, grup interesi, shkollë apo universitet, i përbërë nga së paku 50 persona, kërkon një interpelancë me Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin ose çdo ministër, për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre.
- **“Shkolla ime”** – Nëpërmjet këtij seksioni, një grupim personash, i përbërë nga të paktën pesë nxënës, pesë

32 Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian, Publikuar nga: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Shtypshkronja Flesh Tiranë, Shkurt 2021.

33 Urdhri nr. 113 i Kryeministrit datë 30.12.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian”.

34 Shënim: në datë 30 nëntor 2021, Presidenti Ilir Meta ka rikthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin duke argumentuar se shkel Kushtetutën dhe autonominë e pushtetit vendor si dhe centralizon më shumë pushtet tek një agjenci në varësi direkte të kryeministrit.

35 Ligji nr. 107/2021 ‘Për Bashkëqeverisjen’

prindër dhe pesë mësues, paraqet një ide apo projekt për të përmirësuar institucionin arsimor ku bën pjesë apo mësimdhënien në të;

- **“Nota ime”** – Nëpërmjet këtij seksioni, çdo qytetar vendos një vlerësim për institucionin, zyrën apo sportelin, pas përfitimit të një shërbimi publik të ofruar prej tij. Nga kjo notë e vendosur nga qytetarët përllongarit notat mesatare mujore e pëlqyeshmërisë së institucionit mbi nivelin e ofrimit të shërbimit, e cila bëhet publike periodikisht në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam”.
- **“Dua të kontribuoj”** – Nëpërmjet këtij seksioni, çdo qytetar shpreh interesin e tij për të ndihmuar ose për t’u angazhuar në administratë, me kohë të plotë ose të pjesshme ose si ekspert në projekte.
- **“Kuvendimi ynë”** – Nëpërmjet këtij seksioni, çdo qytetar shpreh mendimin e tij mbi çështjet që

parashtrihen për diskutim në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam”, me qëllim krijimin e një forumi publik virtual diskutimi ndërmjet qytetarëve dhe administratës shtetërore.³⁶

Ndërveprimi i platformës me individët apo subjektet private dhe me institucionet e administratës shtetërore kryhet vetëm në mënyrë elektronike përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”. Procesi i autentifikimit dhe i identifikimit në platformën realizohet nëpërmjet “Single-Sign-On” të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, e-albania.³⁷

Në Planin Kombëtar për Rininë 2015-2020, nxitja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset dhe vendimmarrjet

36 Platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”, <https://www.shqiperi-aqeduam.al/>

37 Informacion udhezues mbi aksesimin e Portalit: https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/04/Per_rregjistrimin_ne_Platforme.pdf

4

TË RINJTË SI PARTNERË NË MIRËQEVERISJE

demokratike përbën objektivin e parë strategjik.³⁸ Në këtë frymë edhe në ligjin nr. 75/2019 "Për rininë" specifikohet si një ndër parimet për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve **garantimi i pjesëmarrjes së tyre në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve.**³⁹ Në këtë kuadër, ngarkohen institucionet qendrore për të siguruar konsultimin dhe marrjen e mendimeve nga të rinjtë për politika që i targetojnë ata duke ngarkuar me përgjegjësi direkte Ministrinë përgjegjëse për rininë për të siguruar zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë lidhur me politikën dhe programet rinore në vend, si dhe programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.⁴⁰

Në këtë punim u paraqitën një sërë instrumentash ligjorë nëpërmjet të cilave mund të sigurohet pjesëmarrja e të rinjve si mobilizues socialë në **proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse** fokusuar tek e drejta për informim, konsultim publik dhe bashkëqeverisje. Për një përdorim sa më përmbajtësor të këtyre instrumenteve është me vlerë ndërgjegjësimi, informimi dhe rritja e kapaciteteve të të rinjve në përdorimin e tyre, si mjete për zhvillimin e potencialeve të të rinjve dhe fuqizimin e tyre si mobilizues social dhe partnerë në mirëqeverisje për të cilat do ndalemi si vijon.

Rritje e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi të drejtën për informim, konsultim publik dhe

38 Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, 2015-2020.

39 Neni 4/b, Ligji nr. 75/2019 "Për rininë"

40 Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, "Rinia" është fushë e përgjegjësisë së Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

bashkëqeverisje

Ndërgjegjësimi i të rinjve mbi vlerën e përdorimit të instrumenteve që u sigurojnë akses në informacion, u japin zë në konsultim publik të politikave dhe akteve ligjore si dhe i bëjnë aktorë në bashkëqeverisje, është i domosdoshëm për angazhim sa më përmbajtësor të tyre. Në punim u cituan disa nga gjetjet e Raportit për Shqipërinë 2020 dhe 2021 të Komisionit Evropian ndër të cilat dhe përdorimi i ulët i instrumenteve që sigurojnë konsultimin publik dhe përqendrimin më së shumti të institucioneve në realizimin e procesit formal i cili është detyrim ligjor sesa mbi përmbajtje, duke bërë që konsultimet shpesh të mbeten 'ushtrime artificiale'.⁴¹ Në mbështetje të këtij konstatimi *nevojiten përpjekje thelbësore për të siguruar konsultime kuptimplota dhe sistematike* të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i tyre është thelbësor. Çdo i ri i interesuar mund të konsultojë planin vjetor për projektaktet që kanë impakt në sektorin e rinisë dhe që do të jenë në konsultim publik në platformën e dedikuar të këtij procesi dhe jo vetëm.

Në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë" ngelet dhe një akt i pamiruar "Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore". Gjithsesi, në fokus duhet të jetë jo vetëm konsultimi gjatë hartimit të akteve dhe politikave por edhe informimi/monitorimi mbi zbatimin e tyre. Aktualisht janë miratuar katër nga pesë aktet nënligjore të parashikuara të ligjit nr. 75/2019, të cilat janë:

1. Vendimi nr. 681, datë 2.9.2020 i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)"
2. Vendimi nr. 969, datë 2.12.2020 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit

41 European Commission, Albania 2021 Report, Brussels.

Kombëtar të Rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij"

3. Vendimi nr. 1141, datë 24.12.2020 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë"
4. Vendimi nr. 274, datë 12.5.2021 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore"

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të ligjit "Për Rininë", një tjetër çështje në interes është ngritja dhe konsolidimi i Këshillave Vendorë të Rinisë. Krijimi i këtyre Këshillave është një hap i rëndësishëm në fuqizimin e të rinjve nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e vendimmarrjes së pushtetit vendor.

Një tjetër proces ku rekomandohet angazhim përmbajtësor i të rinjve është draftimi i Strategjisë Kombëtare për Rininë e planifikuar të miratohet në vitin 2022. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është aktualisht duke zhvilluar tur takimesh konsultative duke ftuar të gjithë të rinjtë që të bëhen pjesë.⁴²

Angazhimi i të rinjve në procesin e konsultimit të projekt buxhetit për rininë është po ashtu një aspekt qendror për sa i përket informimit mbi të dhe ndikimit në orientimin e politikave rinore me mbështetje buxhetore. Aktualisht, në Planin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 (PBA 21-23), buxheti i dedikuar për financimin e sektorit të rinisë është i përfshirë në programin buxhetor 'Sporti dhe Rinia' në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Objektivat që adresojnë rininë në PBA aktual 21-23 janë: 'Të përmirësojmë cilësinë e jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimmarrje', si dhe 'Mbështetja financiare me investime për rristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim.'⁴³ Me planifikimin buxhetor të ri, programi i rinisë kalon nën varësi të Ministrit të Shtetit për Fëmijët dhe Rininë.

Përdorimi përmbajtësor i këtyre të drejtave, jo vetëm mbështet zhvillimin e potencialeve të të rinjve, i fuqizon

duke i kthyer në aktorë vendimmarrës por ndikon dhe në përmirësimin e zbatimit të kuadrit ligjor. Identifikimi nga të rinjtë i mangësive apo problematikave që mund të hasin në përdorimin e këtyre instrumentave dhe rritja e presionit qytetar ndikon në përmirësimin e zbatimit të tyre, nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike duke i kthyer kështu të rinjtë në partnerë në mirëqeverisje.

Kuadri ligjor për të drejtat e referuara, ka parashikuar instancat ankimuese për të siguruar zbatimin e tyre sa më të plotë si Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Një shembull i bashkëpunimit me Komisionerin në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të instrumentave të referuar është ai me Qëndresën Qytetare. Kjo organizatë në bashkëpunim me Friedrich Ebert ka punuar për përgatitjen e një Programi Model të Transparencës të dedikuar për institucionet publike të arsimit të lartë, të cilën e ka paraqitur tek Komisioneri dhe pritet për tu miratuar duke synuar sipas tyre rritjen e transparencës nga këto institucione.⁴⁴

Aftësim digjital i të rinjve në përdorimin e instrumentave elektronikë

Në funksion të e-qeverisjes


Digjitalizimi i shërbimeve publike ka qenë në fokus të reformës së administratës publike me qëllim thjeshtimin dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike vetëm *online* nëpërmjet platformës qeveritare *e-Albania*. Shumica e instrumentave ligjorë të referuar në punim janë instrumenta elektronikë, si portalet për konsultimin publik, për bashkëqeverisjen, komunikimi me koordinatoret për të drejtën e informimit, platformat për transparencën, e të tjera. Në këtë kuadër, përveç ndërgjegjësimit për përdorimin e instrumentave, sugjerohet aftësimi i vazhdueshëm i të rinjve mbi kompetencën digjitale për përdorimin sa më përmbajtësor të tyre.

Rezultatet e Anketës mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët të INSTAT mbi përdorimin e *e-qeverisjes* tregojnë trend pozitiv rritjeje për vitin 2020 të përqindjes së qytetarëve të cilët kontaktojnë nëpërmjet internetit me autoritetet publike dhe aksesojnë shërbime publike. Rritja më e lartë është shënuar për kategorinë "marrjen e informacionit nga faqet ose aplikacionet e internetit" me 13,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2019. 93,9% e individëve që kanë ndërvepruar me autoritet publike nëpërmjet internetit kanë mbetur të kënaqur me

42 Strategjia e Re Kombëtare për Rininë 2022-2029, NewsNTV publikuar në datë 5.10.2021, parë për herë të fundit në datë 2.12.2021. <https://ntv.al/minister-i-shtetit-rinine-dhe-femijet-bora-muzhaqi-strategjia-e-re-kombetare-per-rinine-2022-2029/>

43 Ministria e Arsimit dhe Sportit, Financat, <http://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>

44 Xhemollari, R. Niklekaj, Qendresa Qytetare R. Arsimi i Lartë, Sfida për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit, Electronic ed.: Tirana, FES, 2021



shërbimet publike të ofruara.⁴⁵⁴⁶

Përqindja e të rinjve 18-24 vjeç që përdorin internetin për të komunikuar me autoritetet publike në vitin 2019 është 23.35% (tabela më poshtë). Ndërkohë shihet rritje pozitive nga viti 2018 në vitin 2019 me rreth 3% më shumë të rinj përdorues me një diferencë rreth 2% më shumë për gjininë femërore. Për vitin 2020 nuk janë publikuar të dhënat e agreguara sipas grupmoshave por është e pritshme një rritje në përdorim të internetit për komunikimin me autoritetet publike për arsye të izolimit nga pandemia.⁴⁷

Pavarsisht trendit pozitiv në rritje që tregojnë këto të dhëna, përqindja e të rinjve (vetëm rreth 23%) e grupmoshës 18-24 vjeç që kontaktojnë nëpërmjet internetit me autoritetet publike dhe aksesojnë shërbime publike nuk është e lartë. Ndërgjegjësimi dhe aftësimi digjital i të rinjve duhet të jetë në fokus për të rritur angazhimin e të rinjve në përdorimin e internetit për qasje në e-qeverisje si dhe për të komunikuar me autoritetet publike bazuar në të drejtat e sanksionuara për informim, konsultim dhe bashkëqeverisje.

45 Anketat mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësisë ekonomike familjare (NJEF) dhe ka objekt të gjithë individët të grup-moshës 16-74 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri.

46 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje 2020, Publikuar në Tiranë, më 02 Prill 2021. http://www.instat.gov.al/media/8267/ict-2020_shqip_.pdf

47 Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, Të dhëna mbi periudhën kohore 2016-2019, publikuar në Tiranë, 01-06-2021. http://www.instat.gov.al/media/8432/instat_unicef_2021_statistics_publication_al.pdf

Sipas UN Youth, 'komunikimi TIK ndërmjet qeverisë dhe qytetarëve ka ndikim mbi rininë, duke i bërë ata të ndihën më të lidhur, të angazhuar dhe të dëgjuar. Edhe kur iniciativat TIK të qeverisë nuk janë të fokusuara tek të rinjtë, të rinjtë e perceptojnë një komunikim të tillë si të drejtuar kryesisht për grupmoshën e tyre'.⁴⁸

Aftësim digjital i të rinjve në përdorimin e instrumentave elektronikë

Në funksion të aksesit në informacion për mundësi zhvillimi personal

Përgjatë punimit u theksua detyrimi i autoriteteve publike për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës në të cilën përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, si edhe mënyra e bërjes publike e këtij informacioni. Të rinjtë me aftësi më të avancuara të TIK-ut kanë mundësi qasjese më lehtësisht në informacion relevant të publikuar në ueb-et zyrtare të autoriteteve publike dhe jo vetëm. Në këtë kontekst, aftësimi digjital i të rinjve në përdorimin e instrumentave elektronikë është i rëndësishëm jo vetëm për fuqizimin e tyre si mobilizues socialë por edhe për lehtësimin në qasje të informacionit si mundësi zhvillimi personal të mëtejshëm. Për të përmbyllur, në mbështetje të qasjes në informacion, në vijim jepet një listë e disa prej ueb-eve zyrtare me mundësi dhe informacion për të rinjtë përveç instrumentave të identifikuar gjatë punimit.

Përpjekje thelbësore për të siguruar që proceset e

48 UN, Youth and ICT, <https://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-icts.pdf>

Shërbimet online në tërësi të ofruara në e-albania	https://e-albania.al/
Shpallje për punësim në administratë publike:	http://dap.gov.al/
Program i punësimit të përkohshëm në institucionet e administratës shtetërore:	http://dap.gov.al/vende-vakante/ekselenca
Programi Kombëtar i Praktikave të Punës:	https://praktika.arsimi.gov.al/
Programi i Fondit të Ekselencës:	http://arsimi.gov.al/fondi-i-ekselences/ https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9539
Informacione dhe këshillim, udhëzime për punësim, shërbime të tjera ndërmjetësimi dhe programet e	http://www.akpa.gov.al/sherbimet/programet-e-tregut-te-punes/
Bursa dhe programe studimi jashtë Shqipërisë sipas marrëveshjeve me shtetet e huaja:	http://arsimi.gov.al/bursa-dhe-programe-studimi/
Thirje për aplikime dhe mundësi nga Agjencia Kombëtare e Rinisë:	http://rinia.gov.al/
Fonde grante AIDA:	https://www.aida.gov.al/sq/nvm/iniciativat-e-financimit/fondet-e-aida-s
Qendra e Botimeve Zyrtare:	https://qbz.gov.al/
Kërko për akte/Kuvendi i Shqipërisë:	https://www.parlament.al/LibrariaAkteve

5

REKOMANDIME

konsultimit publik të jenë kuptimplota dhe sistematike nga autoritetet publike.

Rritet ndërgjegjësimi i të rinjve mbi të drejtën për informim, konsultim publik dhe bashkëqeverisje dhe përdorimit të instrumenteve ligjore për qasje kundrejt tyre. Rritje e angazhimit të të rinjve në proceset e hartimit të akteve ligjore, politikave dhe programeve si dhe hartimit të buxhetit me impakt në sektorin e rinisë.

Rritja e presionit qytetar nga të rinjtë karshi autoriteteve publike duke u informuar dhe monitoruar vazhdueshëm mbi zbatimin e politikave dhe programeve rinore.

Identifikimi i mangësive apo problematikave në zbatimin dhe përdorimin përmbajtësor të instrumentave ligjorë të të drejtave të referuara në punim, nxitin integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike, duke i kthyer kështu të rinjtë në partnerë të mirëqeverisjes.

Aftësim digjital i të rinjve në përdorimin e instrumentave elektronikë/digjitalë në funksion të aksesit në informacion për mundësi zhvillimi personal dhe qasje në e-qeverisje/shërbime publike elektronike.

Departamenti i Administratës Publike, *Raporti Vjetor i*

6

DOKUMENTE TË KONSULTUARA

Monitorimit 2020, Tiranë, prill 2021

European Commission, *Albania 2020 Report*, Brussels

European Commission, *Albania 2021 Report*, Brussels

Informacion udhëzues mbi aksesimin e Portalit: https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/04/Per_rregjistrimin_ne_Platforme.pdf

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), *Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian*, Publikuar nga: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Shtypshkronja Flesh Tiranë, Shkurt 2021

Ministria e Arsimit dhe Sportit, Financat, <http://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>

OECD, *Citizens as Partners: Information, Consultation and Public Participation in Policy-Making - Country Case Studies*, 2001.

INSTAT, *Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje 2020*, Publikuar në Tiranë, më 02 Prill 2021. http://www.instat.gov.al/media/8267/ict-2020_shqip_.pdf

Platforma "Me ty për Shqipërinë që duam", <https://www.shqiperiaqeduam.al/>

Platforma e konsultimit on line të projektligjeve të Kuvendit,

Platforma e Konsultimit Publik, konsultimi.gov.al, https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Ligji_per_Njoftimin_dhe_Konsultimin_Publik-1.pdf parë për herë të fundit tetor 2021

NewsNTV, 'Strategjia e re Kombëtare për Rininë 2022-2029', publikuar në datë 5.10.2021, parë për herë të fundit në datë 2.12.2021. <https://ntv.al/minister-i-shtetit-rinine-dhe-femijet-bora-muzhaqi-strategjia-e-re->

[kombetare-per-rinine-2022-2029/](#)

INSTAT, *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, Të dhëna mbi periudhën kohore 2016-2019*, publikuar në Tiranë, 01-06-2021. http://www.instat.gov.al/media/8432/instat_unicef_2021_statistics_publication_al.pdf

UN, *Youth and ICT*, <https://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-icts.pdf>

Xhemollari, R. Niklekaj, Qendresa Qytetare R. *Arsimi i Lartë, Sfida për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit*, Electronic ed.: Tirana, FES, 2021

LIGJE DHE VENDIME

Kushtetuta e Shqipërisë

Ligji nr. 107/2021 'Për Bashkëqeverisjen';

Ligji nr. 119/2014 'Për të drejtën e informimit';

Ligji nr. 146/2014 'Për njoftimin dhe konsultimin publik'

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar

Ligji nr. 75/2019 "Për rininë"

Udhëzimi plotësues i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, nr. 19 datë 9.7.2020

Urdhri nr. 113 i Kryeministrit datë 30.12.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian";

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 11.4.2018 'Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar,

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/ IPSIS)'

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021

'Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021– 2023'.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 29.10.2021
'Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndhmës''

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 6.5.2015,

'Mbi miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë, 2015-2020'

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021,
'Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët'

7

ANEKSI 1

Koordinatorët për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Institucioni	E-mail
Kuvendi	suela.huta@parlament.al
Kryeministria	merita.bundo@kryeministria.al
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	liridona.bodi@mfa.gov.al
Ministria e Mbrojtjes	informimi_mm@mod.gov.al
Ministria e Mbrojtjes	informimi_mm@mbrojtja.gov.al
Ministria e Brendshme	ardian.bit@mb.gov.al
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	jonida.kaza@financa.gov.al
Ministria e Arsimit dhe Sportit	koordinatori@arsimi.gov.al
Ministria Drejtësisë	koordinatori.informimi@drejtesia.gov"
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	nexhila.kodra@shendetesia.gov.al
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	fludian.cuka@turizmi.gov.al
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	enxhi.toska@infrastruktura.gov.al
Autoriteti i Mediave Audiovizive	mirela.mileti@ama.gov.al
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	info@akep.al
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	gezim.licaj@amf.gov.al
Agjencia Telegrafike Shqiptare	neviladalipi@gmail.com
Agjencia e Prokurimeve Publike	florian.lula@app.gov.al
Avokati Popullit	koordinatori.informimi@avokatipopullit.gov.al
Autoriteti i Konkurrencës	daniela.mehmeti@caa.gov.al
Autoriteti Për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit	selami.zalli@autoritetidosjeve.gov.al
Agjencia e Sigurimit të Depozitave	mshkurti@asd.gov.al
Banka e Shqipërisë	nsamarxhiu@bankofalbania.org
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	dpa@arkiva.gov.al
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	hermelinda.hysenaj@tatime.gov.al
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	oligert.kume@dogana.gov.al
Enti Rregullator i Energjisë	koordinatori@ere.gov.al
Enti Rregullator i Ujit	malvina.zaja@erru.al
Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunitetit	info@iskk.gov.al
Instituti i Statistikave	axhikneli@instat.gov.al
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	olsi.peto@kqz.gov.al
Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	griselda.haska@kmshc.al
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	irida.troshani@kmd.al

MBI AUTOREN

Dikensa Gjokutaj mban titullin Msc në 'Teori Politike' në Universitetin e Tiranës dhe Msc në 'Filozofi Gjermane dhe Franceze në hapësirën Evropiane', *Diplomë e Përbashkët* lëshuar nga Universiteti i Luksemburgut, Universiteti Tuluzë II '*Le Mirail*' dhe Universiteti Katolik i Luvenit, mbështetur me bursë *Erasmus Mundus* nga Komisioni Evropian. Ekspertiza e saj konsiston në fushën e administrimit publik, politikave rinore dhe Monitorimit-Vlerësimit. Ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit po ashtu, më hershëm pozicionin e specialistit të politikave rinore pranë ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

IMPRINT

Fondacioni "Friedrich Ebert" | Rr. "Kajo Karafili" Nd. 14, Hyrja 2 kati i I | Tiranë | Shqipëri

Pergjegjës:

Stine Klapper | Drejtoreshë e Fondacionit "Friedrich Ebert"

Tel: 00355 4 22 509 86

www.tirana.fes.de

Menaxhere Programi:

Rezarta Ajazaj

Publikimet e Friedrich-Ebert-Stiftung nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratimin me shkrim të FES

TË RINJTË SI PARTNERË NË MIRËQEVERISJE

Udhëzues mbi instrumentat ligjorë për përfshirje dhe transparencë në politikbërje



Sanksionimi i të drejtës për informacion dhe konsultim publik ka qenë në fokus që prej vitit 2014. Aktualisht është në proces sanksionimi e drejta 'për bashkëqeverisje'. Ligji 'Për Rininë' konfirmon frymën e kuadrit ligjor të miratuar dhe sanksionon garantimin e pjesëmarrjes së të



rinjve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse. Ky punim synon të informojë të rinjtë mbi disa prej instrumentave me anë të të cilave të qasen: në informacion publik, konsultim publik dhe si aktorë në bashkëqeverisje. Sipas KE-së duhet përdorim më përmbajtësor i këtyre instrumentave nga



autoritetet publike. Në këtë kuadër, ndërgjegjësimi i të rinjve mbi përdorimin e tyre është kyç jo vetëm për fuqizimin si mobilizues socialë por në rritjen e zbatimit të kuadrit ligjor dhe transparencës nga autoritetet publike sepse të rinjtë janë partnerë në mirëqeverisje.

Për më shumë informacion:
<https://www.tirana.fes.de/al/publikime/>